



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 501/15 prot.

Tiranë, më 25.11.2024

VENDIM
Nr. 74, datë 25.11.2024

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 62, DATË 04.11.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 62, datë 04.11.2024, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 4040 prot., datë 22.07.2024, të eprorit direkt, për moskonfirmimin si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës të nëpunësit *****”.

KONSTATOVA SE:

Permes shkresave të regjistruara me nr. 501 prot., datë 06.09.2024; nr. 501/2 prot., datë 17.09.2024; nr. 501/2, datë 02.10.2024 dhe nr. 501/6 prot., datë 02.10.2024, nëpunësi civil në periudhë prove ***** ka informuar Komisionerin, duke pretenduar për disa parregullsi të kryera ose të lejuara nga zyrtarët vlerësues dhe eprori direkt, gjatë aplikimit të institutit të periudhës së provës, e konkretisht në kryerjen e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për këtë periudhë, duke sjellë si pasojë moskonfirmimin e tij si nëpunës civil.

Pas shqyrtimit të të dhënave që përmbante informacioni i përcjellë, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ mbi çështjen në fjalë.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 62, datë 04.11.2024, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 4040

*prot., datë 22.07.2024, të eprorit direkt, për moskonfirmimin si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës të nëpunësit *****”.*

Në lidhje me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi, institucioni dhe njësia përgjegjëse (DAP) kanë informuar Komisionerin në lidhje me situatën ligjore dhe faktike të këtij rasti, duke bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 62, datë 04.11.2024, si dhe duke verifikuar dokumentacionin bashkëlidhur shkresës nr. 501/12 prot., datë 07.11.2024, të Departamentit të Administratës Publike si dhe shkresës nr. 501/13, datë 11.11.2024, të Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve, Aseteve dhe Shërbimeve Sektori i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar Komisionerit, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikat 1-3 të dispozitivit të vendimit paralajmërues, objekt i këtij verifikimi, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet e ngarkuara nga ligji me detyra të posaçme në administrimin e shërbimit civil gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë të marrin masat si më poshtë:

- Përsëritjen e procesit të vlerësimit për nëpunësin ***** , për gjithë periudhën e provës, nga ana e zyrtarëve të ngarkuar me këtë proces, që janë eprori direkt dhe zyrtarët vlerësues
- Njësia përgjegjëse duhet të marrë masat për njoftimin e zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit, në lidhje me detyrimin për përsëritjen e procesit të vlerësimit
- Anullimin e aktit nr. 4040/1 prot., datë 30.07.2024 për lirimin nga shërbimi civil të nepunësit ***** , nga organi që e ka nxjerrë atë.

Nga informacioni i përcjellë përmes shkresave të sipërcituara, rezulton se, ***** i është drejtuar me kërkesë-padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me datë 04.09.2024, duke thërritur si palë të paditura Ministrinë e Drejtësisë si dhe Departamentin e Administratës Publike, ku ndër të tjera ka kërkuar: *“Kundërshtimin e aktit të vlerësimit (të pjesshëm) në punë të datës 29.02.2024, i aktit të vlerësimit (të pjesshëm) në punë të datës 21.07.2024, dhe i vendimit nr. 4040 prot., datë 22.07.2024 të Drejtorit të Drejtorisë së Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion “Në lidhje me konfirmimin e statusit të nëpunësit civil”.*

Në kushtet kur çështja do të zgjidhet përfundimisht në rrugë gjyqësore, vlerësoj se, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr.49/2012, *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, si dhe nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, për shkak të juridiksionit që tashmë i përket gjykatës, zbatimi i këtij vendimi nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, i ndryshuar, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 62, datë 04.11.2024, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 4040 prot., datë 22.07.2024, të eprorit direkt, për moskonfirmimin si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës të nëpunësit *****”.
2. Për këtë vendim të njoftohet, Ministria e Drejtësisë, njësia përgjegjëse Departamenti i Administratës Publike, si dhe *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha